

Prishtinë: 02.11.2007  
Kodi i ZRRE-së: D\_63\_2007  
Nr. I Referencës ERO/CPD\_R\_47\_10\_07

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
3. Procesverbalin e datës 20.03.2006 të KEK Sh.A-së mbi ndërrimin e njehsorit të “ALBIMI LTD”-së;
4. Ankesën e ALBIMI LTD-së të bërë në KEK Sh.A me datë 30 maj 2006;
5. Ankesën e ALBIMI LTD-së të bërë në KEK Sh.A me datë 19.06.2006;
6. Ankesën e ALBIMI LTD-së të bërë në KEK Sh.A me datë 15.11.2006;
7. Përgjigjen e KEK Sh.A-së, të datës 12.12.2006 në ankesën e konsumatorit për faturat e muajve 03/04-2006;
8. Ankesën e ALBIMI LTD-së të bërë në KEK Sh.A me datë 05.03.2007;
9. Ankesën e ALBIMI LTD-së të datës 23.03.2007 të bërë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) të Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas nenit 14.1 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të regjistruar me 10.04.2007 me numër regjistrimi 55/04.2007;
10. Transaksionet e konsumatorit DGL 9000127, njehsori 35535804.
11. Procesverbalet e datës: 01.04.2006;01.05.2006;01.06.2006;01.07.2006; dhe 18.10.2006.
12. Procesverbalin e njehsorit digjital të ALBIMI LTD-së, nr njehsorit-35535804 për vitin 2006 dhe 2007.
13. Disa foto të bëra në fabrikë nga konsumatori (fotot nuk kanë datë).
14. Rekomandimi i DMK bërë Bordit të ZRRE-së, në pajtim me Nenin 14.5 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; të datës 22.10.2007 Nr. ZRRE/DMK\_R\_47\_10\_07; dhe
15. Neni 18 të Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 01.11.2007 morri këtë:**

### VENDIM

**REFUZOHET** ankesa e konsumatorit “ALBIMI LTD” Sh.P.K – fabrikë për prodhimin e tepihëve dhe tjerit, Rr.”A. Tahiri” P.N Gjilan (Shifra e konsumatorit - DGL – 9000127), për arsyet e paraqitura në Arsyetimin e këtij rekomandimi.

## Arsyetim

1. Konsumatori “ALBIMI” LTD me datë 30 maj 2006 ka bërë ankesë në KEK Sh.A në lidhje me faturat si në vijim:

○ DGL-9000124 3/2006/R	05.04.2006	7,622.02€
○ DGL-9000127 3/2006/16700	31.03.2006	52.22€
○ DGL-9000127 4/2006/R	04.05.2006	2,874.72€

*Në këtë ankesë “ALBIMI” LTD ka kërkuar nga KEK Sh.A që të korrigojen faturat e rrymës edhe një herë dhe të vendoset njehsori në trafo të “ALBIMI” LTD-së për shkak se të gjitha leximet po bëhen pa prezencë të konsumatorit dhe konsumatori nuk ka qasje në njehsor.*

2. Konsumatori “ALBIMI” LTD me 19.06.2006 ka bërë ankesë në KEK Sh.A ku ka kërkuar që të shqyrtohet fatura e rrymës së shpenzuar:

○ DGL-9000127 5/2006/R	1,847.99€
------------------------	-----------

*Në këtë ankesë konsumatori kërkon nga KEK Sh.A që shpenzimet e rrymës të llogariten në bazë të orës së vendosur në trafo të konsumatorit, ku cek se rryma nuk është e kyçur në pjesën më të madhe të objektit për shkak të dëmtimit të kulmit dhe për të vërtetuar këtë, me shkresë dërgon edhe disa foto (në foto nuk ka datë) ku shihen se në objekt ka ujë, dhe se nuk ka mund të harxhoj shumën e lartshënuar.*

3. Konsumatori “ALBIMI” LTD me 15.11.2006 ka bërë ankesë në KEK Sh.A ku ka kërkuar që të shqyrtohet fatura e rrymës së shpenzuar:

○ DGL-900127 10/2006/R	1,875.61€
------------------------	-----------

*Në këtë shkresë konsumatori kërkon nga KEK Sh.A që leximi të bëhet prej datës 1-2 të muajit, si dhe të bëhet në prezencë të një përfaqësuesi të “ALBIMI”-t.*

4. Me datë 12.12.2006 KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit në Gjilan i përgjigjet konsumatorit:

*“Lidhur me ankesën tuaj të datës 12.04.2006 për faturat e muajve 03/04-2006 përmirësimi është bërë me 24.05.2006 ku stornohet maksigrafi në vlerë prej 5,187.52€ me arsyetimin e Shërbimit të Matjes dhe Faturimit. Mirëpo në ankesat e mëvonshme të datave 05.05.06 dhe 15.11.06 ne nuk kemi mund të përmirësojmë asgjë meqë nuk na është kthyer kurrfarë arsytimi nga Shërbimi i Matjes që të korrigohet fatura eventuale, andaj ju lutem drejtohuni në Shërbimin e Matjes në Gjilan për përgjigje meqë ankesën tuaj e kemi adresuar në këtë shërbim”.*

5. Konsumatori “ALBIMI” LTD me 15.03.2007 ka bërë ankesë në KEK Sh.A ku ka kërkuar që të shqyrtohet të gjithë faturat e rrymës së shpenzuar që nga data 02.03.2006, pas privatizimit dhe të bëhet rileximi i njehsorit në prezencë të personit të autorizuar nga “ALBIMI” pasi që të gjitha leximet janë bërë pa prezencë të ndonjë përfaqësuesi të “ALBIMI”-t.

6. Me datë 23.03.2007 Konsumatori “ALBIMI” LTD në ankesën e tij drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE apelon përgjigjen e KEK-ut të datës 12.12.2006.

7. Konsumatori “ALBIMI” LTD ka kërkuar që të bëhet:

*“ALBIMI LTD” kërkon nga KEK-u që t’i korrigjoj shpenzimet e rrymës për 12 muajt e kaluar, të llogaritet rryma në bazë të shpenzimeve të energjisë elektrike që janë evidentuar në njehsorin i cili gjendet në trafo të “ALBIMI”-t dhe në të ardhmen shpenzimet e rrymës të faturohen në bazë të njehsorit i cili është i vendosur në “ALBIMI”-n (që do t’iu mundësoj përfaqësuesve të fabrikës “ALBIMI LTD” edhe kontrollime ditore të shpenzimeve dhe kalkulimin e saktë të prodhimit),si dhe gjatë leximit në të ardhmen të jetë prezent përfaqësuesi i ALBIMI-t*

8. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE gjatë analizës dhe shqyrtimit të bërë dokumentacioneve të ofruara nga KEK Sh.A dhe konsumatorit, si dhe vizitës dhe bisedave të zhvilluara në vendin e ngjarjes me përfaqësuesit e KEK SH.A dhe me përfaqësuesit e konsumatorit, ka propozuar Bordit të ZRrE-së që të refuzoj ankesën e konsumatorit me Nr. 55/04 2007 për arsye si në vazhdim:

8.1. Me qëllim të sqarimit të rastit në fjalë, me datë 09.10.2007 përfaqësues të ZRrE-së mbajnë një mbledhje në Gjilan me përfaqësues të KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit i Prishtinës; KEK Sh.A – Gjilan, si dhe me përfaqësues të ALBIMI-t. Procesverbalet e KEK Sh.A-së të datës: 01.04.2006; 01.05.2006; 01.06.2006; 01.07.2006; dhe 18.10.2006 tregojnë gjendjen e harxhimit të energjisë së konsumatorit, për të cilat konsumatori deklaroi se nuk janë të nënshkruara nga ana e punëtorëve të fabrikës së tij, mirëpo për të vërtetuar këtë harxhim të energjisë elektrike nga konsumatori, përfaqësuesi i KEK Sh.A-dega në Gjilan, shpjegon se mund të vërtetohen këto procesverbale pasi që konsumatori posedon njehsor digjital në të cilin mund të shihet gjendja e harxhimit të energjisë dhe e maksigrafit për 24 muajt e fundit (e që përfshinë edhe periudhën për të cilën konsumatori i konteston faturat).

8.2. Në procesverbalin e njehsorit digjital të “ALBIMI” LTD-së, dërguar në ZRrE me datë 11.10.2007, nr njehsorit-35535804 për vitin 2006 dhe 2007, shihet gjendja e njehsorit dhe maksigrafit, ku njehsori ka regjistruar energjinë e shpenzuar sipas procesverbaleve të cilat KEK Sh.A i ka prezantuar për ZRrE-në lidhur me konsumatorin.

8.3. Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve i ZRrE-së duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRrE-së, përgjigjen e KEK Sh.A dhënë konsumatorit, analizimin e dëshmimeve të paraqitura dhe duke u bazuar në Kornizën Ligjore të Aplikueshme në Kosovë, konstaton se: nga ana e KEK Sh.A janë zbatuar të gjitha procedurat e parapara me ligjet e aplikueshme dhe se përgjigja e KEK-ut dhënë konsumatorit është në pajtim me legjislacionin në fuqi (përveç se përgjigja e datës 12.12.2006 e KEK Sh.A-së dhënë konsumatorit është dashur të jetë më e qartë për konsumatorin). Duke pasur parasysh këtë që u tha më lartë DMK **refuzon** ankesën e konsumatorit si të pabazë.

9. Më 01.11.2007 Bordi i ZRrE-së ka mbajtur mbledhjen dhe ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që **të refuzon** ankesën e konsumatorit për arsye të paraqitura në pikën e 8 të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Vendimi konsumatori mund të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda (14) ditëve nga pranimi i Vendimit ose shpalljes së Vendimit në faqen tonë elektronike, cilado që ndodhë e para.

**Kryesuesi i Bordit**

---

**Antarët e Bordit:**

---

---

---

---